



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim

Mbledhja nr. 85

Prishtinë, më 14.5.2024, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Fitore Pacolli-Dalipi, Milazim Salijaj, Isak Shabani, Ekrem Mustafa, Salih Zyba, Samra Ilijazi, Jetmire Vrenezi dhe Albena Reshitaj.

Munguan: Besian Mustafa dhe Ganimete Musliu.

Pjesëmarrës të tjerë: Shefki Kastrati, NDI; nga mediat: Vlerë Mehmeti- KTV, Ilirjana Hoti-BIRN, Edina Avdiu- RTK

Stafi mbështetës i Komisionit: Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Fitore Pacolli-Dalipi, kryetare e Komisionit.**

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dt. 23.4.2024;
3. Shqyrtimi i Projektligjit 08/L-241 për vlerësimin strategjik mjedisor;
4. Shqyrtimi i raporteve me të gjetura për pronat e RTP-së dhe të Fakultetit Teknik nga deputeti Milazim Salijaj, raportues;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Komisioni, me 6 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, e miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbalit nga dt. 23.4.2024

Komisioni, me 6 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, e miratoi procesverbalin nga dt. 23.4.2024.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-241 për vlerësimin strategjik mjedisor

Kryetarja, tha se komisioni ka formuar grupin e punës për këtë projektligj, i cili e ka përgatitur raportin me amendamente për komisionin dhe e ftoi kryesuesen e këtij grupi, deputeten Jetmire Vrenezi, që ta paraqesë raportin me amendamente.

Jetmire Vrenezi, tha se grupi punues, së bashku me përfaqësuesit e MMPHI-së, sponsorë të këtij projektligji, e ka shqyrtuar dhe amendamentuar projektligjin dhe janë propozuar gjithsej 17 amendamente, të cilat ju ftoj t'i votoni për komisionet e përhershme.

Kryetarja, tha se amendamentet janë më shumë teknike dhe nuk e ndryshojnë përmbajtjen e projektligjit që ka ardhur nga ministria. Pasi që nuk kishte diskutues, i ftoi deputetët për votim të raportit me amendamente dhe konstatoi se me 6 vota për, asnjë kundër dhe abstenim, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

1. Miratohen amendamentet e grupit të punës për Projektligjin nr. 08/L-241 për vlerësimin strategjik mjedisor.
2. Raporti me amendamente të procedohet te komisionet e përhershme, sipas procedurës.

4. Shqyrtimi i raporteve me të gjetura për pronat e RTP-së dhe të Fakultetit Teknik nga deputeti Milazim Salijaj, raportues

Kryetarja, tha se në lidhje me këtë temë, ne si komision kemi bërë një hulumtim, ku kanë marrë pjesë disa deputetë, ndërsa punën e këtij e ka kryesuar deputeti Milazim Salijaj, prandaj ia kaloi fjalën atij, që ta prezantojë raportin.

Milazim Salijaj, tha se pas shqetësimeve të ngritura në komision rreth tjetërsimit të pronave publike të RTP-së të Fakultetit Teknik, ne jemi marrë me këtë dhe i kemi vizituar dhe i kemi kontaktuar institucionet relevante, ku kemi siguruar informacione të mjaftueshme. Pas sigurimit të këtyre informacioneve dhe kontakteve, kemi përpiluar dy raporte: njëri për tjetërsimin e pronës publike të RTP-së, me sipërfaqe prej 3.92 hektarë, zona kadastrale Çagllavicë, sipas një aktgjykimi 56/76 të datës 28.4.1976, i Gjykatës së Qarkut në Prizren.

Përveç tjerash, te të gjeturat e këtij raporti, flasin se prona publike është tjetërsuar në bazë të dokumentacionit që dyshohet se është i falsifikuar. Prona publike është tjetërsuar edhe pasi që është marrë vendim nga Bordi i AKP-së, më 2 dhjetor 2020, ku është marrë vendim për likuidimin e ndërmarjes shoqërore të RTP-së. Pas këtij vendimi, është bërë tjetërsimi i pronës, më 17 maj 2022 dhe kjo automatikisht paraqet vepër penale.

Edhe rasti tjetër i tjetërsimit të pronës publike të Fakultetit Teknik, është i ngjashëm dhe ne kemi kërkuar dokumentacione origjinale, por s'kemi mundur t'i sigurojmë as në Agjencinë e Arkivave të Kosovës e as në Komunë.

Raportet i keni marrë dhe tash, si komision, na mbetet që ta adresojmë tutje lëndën, ndërsa mendimi im është që raporti me të gjeturat të adresohet në Prokurorinë e Shtetit dhe ata që kanë keqpërdorur me pronën publike, të dalin para drejtësisë.

Kryetarja, tha se të gjithë deputetët e kanë marrë materialin me email dhe shtoi se jemi konsultuar me Departamentin Ligjor të Kuvendit, sesi të veprojmë më tutje dhe sugjerimi ka qenë që në emër të komisionit, të dërgohet lënda në prokurori. Por, ka pasur edhe diskutime të tjera në komision, që lënda të debatohet edhe në Kuvend.

Salih Zyba, tha se elaborati ka qenë në dispozicion prej mbledhjes së kaluar dhe propozimi im ka qenë të shërbehet përmes Kryesisë dhe Seancës dhe të ketë debat parlamentar, jo të përjashtohet mundësia e ndjekjes përmes prokurorisë. Në mungesë të kolegëve të opozitës e që të gjitha kanë qenë të dakorduar për ta proceduar më tutje, por për versionin ka mbetur se cili do të jetë ai më i

miri. Unë prapë qëndroj në mendimin se lënda të shkojë në Kryesinë e Kuvendit dhe të shihet se cila është mundësia më e mirë për të vendosur për debat parlamentar, të procedohet përmes një grupi të deputetëve nënshkrues apo të diskutohet me një dakordim të të gjitha subjekteve politike në Kryesi.

Kryetarja, tha se kemi konsultuar Kuvendin dhe na kanë sugjeruar për ta dërguar në prokurori, si komision, por kjo nuk na ndalon ne, për të mbajtur debat në Kuvend, sa i përket kësaj çështjeje.

Salih Zyba, shtoi se nuk heq dorë nga dërgimi në prokurori, por nga përvoja, dyshon se organi ndjekës, prokuroria, do të rezultojë me përfundim të një lënde. Iniciativa kemi pasur edhe më herët, por asnjëherë nuk jemi ftuar prej prokurorisë për të dëshmuar. Pastaj një organ i tillë do të kishte mundur ta parandalojë, së bashku me gjykatat, këtë dukuri dhe nuk e kanë bërë. Nuk jam i interesuar që këtë lëndë ta dërgojmë në sirtarët e prokurorisë dhe të mbyllet. Por, nga debatet, do mund të marrë edhe shqetësime të tjera nga qytetaret për rastet të tjera.

Kryetarja, për sqarim, tha se lënda nëse shkon në prokurori, shkon në emër të komisionit. Ne kemi kuorum dhe mund ta marrim vendimin ose mund ta lëmë për takimin e radhës, kur e kemi edhe opozitën dhe të vendosim nëse duam debat në Kuvend.

Salih Zyba, përsëriti edhe një herë se minimumi i kërkesës duhet të jetë që këtë materie ta dërgojmë në Kryesi dhe ata të vendosin për më tutje, ndërsa maksimumi që mund të prodhojë seanca, është një komision hetimor.

Kryetarja, tha se zyra ligjore e Kuvendit na ka rekomanduar për hapat që duhet ndërmarrë dhe nuk jemi kundër debatit në Parlament, por në fund, të gjeturat çfarëdo qofshin ato, prapë do t'i dërgohen prokurorisë, është i vetmi autoritet. Ne mund ta dërgojmë si komision në prokurori ose mund të kërkojmë komision hetimor, që mund të na merr disa muaj kohë dhe përfundojmë me të gjeturat e njëjta. Prandaj, sugjeroj që mund të diskutojmë në seancë, për të pasur rekomandime të tjera prej deputetëve, por në fund përfundon në prokurori.

Salih Zyba, kur e procedojmë, gjasat janë që lënda të zgjasë më shumë se 2 vjet, ndërsa mandati jonë është më i shkurtër. Debatin parlamentar nuk e zëvendëson procedimi në prokurori.

Kryetarja, tha se kur të kërkojmë debat, duhet t'i dërgojmë edhe rekomandimet tona dhe rekomandimi do të ishte që lënda të përcillet në prokurori. Pastaj pyeti, nëse doni që të merrni vendim për ta proceduar tutje në Kryesi dhe Kryesia vendos se a e sheh të nevojshme të ketë debat parlamentar për këtë çështje apo jo.

Ajo i ftoi deputetet për votim dhe konstatoi se me 6 vota për, asnjë kundër dhe abstenim, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

Dy raportet, me të gjetura për pronat e RTP-së dhe të Fakultetit Teknik, t'i procedohen Kryesisë së Kuvendit të Kosovës dhe aty të vendoset për debat parlamentar apo se çka duhet bërë më tutje.

6. Të ndryshme

Salih Zyba, për mbledhjen e radhës, kërkoi që të caktohet për raportim njëri nga ministrat e linjës, dhe në dy mbledhjet e ardhshme, të raportojnë dy ministrat, ai i MBPZHR-së dhe i MMPHI-së.

Kryetarja, tha se javën e kaluar e kemi planifikuar ministrin e MMPHI-së, Liburn Aliu, i cili e ka konfirmuar pjesëmarrjen, por për shkak të mungesë së disa deputetëve, e kemi shtyrë mbledhjen. Po presim ta na konfirmojë ministri, datën se kur mund të vijë. Ndërsa, për ministrin e MBPZHR-së, i kemi dërguar dy kërkesa, dhe për javën e ardhshme, na ka njoftuar se nuk do të jetë në Kosovë dhe po presim konfirmimin për datën 28 maj.

Isak Shabani, si kryesues i grupit punues për Projektligjin për administrimin e ndërtesave dhe lagjeve të banimit në bashkëpronësi, propozoi që të lejohet nga komisioni, organizimi i një punëtorie njëditore jashtë Kuvendit, me shpenzimet e komisionit.

- **Kryetarja konstatoi se komisioni e pranoi dhe e miratoi kërkesën e grupit punues për organizimin e punëtorisë njëditore jashtë Kuvendit për shqyrtimin e Projektligjit për administrimin e ndërtesave dhe lagjeve të banimit në bashkëpronësi.**

Kryetarja njoftoi për planifikimin e organizimit të disa takimeve me grup të fermerëve, bletarët, vreshtarët dhe shoqata të ndryshme, për të diskutuar për problemet dhe kërkesat që ata kanë. Kemi menduar për t'i ftuar në grupe të caktuara në Kuvend dhe këto takime do të kenë shpenzime, prandaj kërkoi konfirmimin e komisionit për këtë.

Salih Zyba, pyeti: cila është kërkesa konkrete e tyre për një takim të tillë, a ka ndonjë adresim konkret nga ata? Pyeti nëse takimi me ta duhet paraprakisht të bëhet e pastaj të bëhet takimi me ministrat apo pas takimit me ministrat. Dhe gjatë këtyre takimeve duhet siguruar pjesëmarrja e zyrtarëve përkatës të ministrive.

Kryetarja theksoi se ka grupe të shumta dhe nuk mund të definojmë ashtu para apo pas takimit me ministrat, sepse nuk do të kryhen për një kohë të shkurtër.

- **Kryetarja konstatoi se komisioni e miratoi kërkesën për mbulimin e shpenzimeve për organizimin e takimeve me grupet e ndryshme të fermerëve.**

Albena Reshitaj, tha se është e shqetësuar për kualitetin e miellit dhe se si komision e kemi monitoruar Ligjin për pasurimin e miellit, ai ka kaluar edhe në Kuvend. Qytetarët vazhdojnë të konsumojnë bukën nga një miell jokualitativ, të cilit i mungojnë 7 vitamina të rëndësishme, që duhet t'i ketë mielli. Pyeti: ku ka mbetur kjo iniciativë dhe të shtyhet përpara që të kemi një miell kualitativ me të gjitha elementet e nevojshme?

Kryetarja, tha se si kryesuese grupit punues për monitorimin e këtij ligji, kemi ardhur në përfundim dhe me rekomandime konkrete, se pasurimi i miellit nuk duhet të vazhdojë si në të kaluarën, sepse nuk kemi të dhëna nëse është bërë pasurimi i miellit dhe cili ka qenë ndikimi i tij. Por, rekomandimi ka qenë që të kemi një **“ligj të veçantë për miellin dhe bukën”**, i cili përcakton edhe standardin dhe përbërjen e bukës, ku si shembull nga vendet e tjera, ata përdorin miell të tipit 800 e më lartë për bukë, ndërsa ai i tipit 400, i cili te ne përdoret për bukë, të përdoret vetëm për kiflet dhe ëmbëlsira. Kuvendi i ka dhënë afat 6 muaj ministrisë përkatëse, për të përmbushur ato rekomandime dhe afati akoma nuk ka kaluar.

Kryetarja informoi për organizimin e një tryeze në Kuvend së bashku me NDI-në **“Për përdorimin e vajit të palmës në produktet ushqimore”**. Ne nuk kemi ligj për këtë dhe nuk e dimë se cili është efekti i vajit të palmës në shëndetin e njeriut. Për kohën e organizimit do të njoftoheni me kohë.

Mbledhja përfundoi në orën 13:50.

E përgatiti: Staf i mbështetës i Komisionit.

Fitore Pacolli-Dalipi,

Kryetare e Komisionit